

20121263081

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR BUJQESI DHE ZHVILLIM
RURAL

Neni 1

Në Ligjin për bujqesi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 49/10 dhe 53/11), në nenin 7 paragrafi (1) pas fjaleve: "për periudhe prej tre vitesh" pika shlyhet dhe shtohen fjalet: "për periudhe prej pese vitesh".

Në paragrafin (5) data "30 qershor" zevendesohen me datën "30 shtator".

Pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) Programet vjetore nga paragrafi (3) i këtij neni miratohen më së voni deri më 31 janar në vitin për të cilin përgatiten."

Neni 2

Në nenin 9 paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Agjencia mban evidence për mjetet e realizuara për masat që zbatohen në pajtim me programet nga neni 7 i këtij ligji dhe dorezon të dhëna në Ministri në çdo tre muaj dhe në Qeveri një herë në vit më së voni deri më 31 mars në vitin vijues për vitin paraprak."

Neni 3

Në nenin 14 paragrafi (2) fjalet: "dhe Agjencia" shlyhen.

Neni 4

Në nenin 15 pas paragrafit (6) shtohen dy paragrafe të rinj (7) dhe (8), si vijojnë:

"(7) Kerkese për ndryshimin e të dhënave në regjistrin unik të ekonomive bujqesore mund të paraqese edhe anetari tjetër i autorizuar i ekonomise bujqesore familjare nga radha e trashëguesve të pronës bujqesore të ekonomise bujqesore familjare në rast të vdekjes së bartesit të ekonomise bujqesore.

(8) Kerkese për ndryshimin e të dhënave në regjistrin unik të ekonomive bujqesore për ekonomi bujqesore bartes i së ciles është person juridik, mund të paraqese personi i autorizuar i personit juridik - bartes i ekonomise bujqesore ose perfaqesuesi i autorizuar i personit juridik - bartes i ekonomise bujqesore."

Paragrafi (7) behet paragraf (9).

Pas paragrafit (8) që behet paragraf (10) shtohen dy paragrafe të rinj (11) dhe (12), si vijojnë:

"(11) Të dhënat e regjistrit nga paragrafi (1) i këtij neni shpallen në formë të përmbledhur, posacerisht sipas kulturave bujqesore, sipas madhësive të ekonomive bujqesore, në komuna dhe në nivel të Republikës së Maqedonisë.

(12) Të drejte kontrolli në të dhënat e regjistrit nga paragrafi (1) i këtij neni ka bartesi i ekonomise familjare bujqesore ose personi tjetër i autorizuar i ekonomise familjare bujqesore ose personi i autorizuar i personit juridik - bartes i ekonomise bujqesore ose perfaqesuesi i autorizuar i personit juridik - bartes i ekonomise bujqesore në çdo kohe me kerkese të paraqitur paraprakisht në Ministri ose me qasje elektronike të ketyre personave pas qasjes shfrytëzuese të marre paraprakisht nga Ministria."

Neni 5

Në nenin 18 paragrafi (1) pas fjales "bujqesise" shtohen fjalet: "dhe zhvillimit rural".

Në paragrafin (2) pas alineje 4 shtohet alineja e re 5, si vijon:

"- Rrjetit rural nacional"

Neni 6

Pas nenit 6 shtohet neni i ri 26-a, si vijon:

"Rrjeti rural nacional"

Neni 26-a

(1) Rrjeti rural nacional paraqet platforme për vendosjen e partneritetit me tere palet e interesuara që veprojnë në mjedise rurale për nevojat e planifikimit, ndjekjes dhe zbatimit të programit nacional për zhvillim rural.

(2) Themelimin, organizimin, anetaresine dhe punen e Rrjetit rural nacional të Republikës së Maqedonise, me propozim të Ministrise i percakton Qeveria.

(3) Ministria siguron perkrahje teknike dhe administrative për punen e Rrjetit rural nacional.

(4) Shpenzimet për themelimin dhe punen e Rrjetit rural nacional financohen nga mjetet për zbatimin e Programit nacional për zhvillim rural dhe/ose Programit shumevjecar për shfrytëzimin e mjeteve financiare të instrumentit për ndihme paraaderuese për zhvillim të bujqësisë dhe zhvillim rural të Bashkimit Evropian.

(5) Menyren dhe kushtet e financimit të punes dhe aktiviteteve të Rrjetit rural nacional, shpenzimet e pranueshme, lartësine e financimit dhe kushtet plotësuese, i percakton ministri."

Neni 7

Në nenin 53 paragrafi (1) alineja 4 perqindja "20%" zevendesohet me perqindjen "30 %".

Neni 8

Në nenin 56 pas fjaleve: "për pagesa direkte" shtohen fjalet: "të paraqitura në një vit kalendarik".

Neni 9

Në nenin 64 paragrafi (9) ndryshohet si vijon:

"Në baze të kriterëve nga paragrafet (3) dhe (8) të ketij neni ministri shpall liste të rajoneve malore në Republikën e Maqedonise, liste të rajoneve me papershtatshmeri natyrore në Republikën e Maqedonise dhe liste të rajoneve me papershtatshmeri specifike në Republikën e Maqedonise në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise"."

Neni 10

Në nenin 70 paragrafi (9) shlyhet.

Paragrafet (10), (11) dhe (12) behen paragrafet (9), (10) dhe (11).

Neni 11

Në nenin 78 paragrafi (8) ndryshohet si vijon:

"Aktivitetet për vendosjen, ndjekjen dhe analizimin e gjendjeve me bimët bujqësore autoktone dhe rasat autoktone të blegtorisë dhe ruajtjen dhe sigurimin e rezervave të detyrueshme gjenetike, ministri mund ta ndajë si sherbim publik ose me autorizim në pajtim me rregullat nga fusha e blegtorisë, materiali faror dhe për mbeltim dhe shendetit dhe mbrojtja e bimeve."

Në paragrafin (10) fjala "ministri" zevendesohet me fjalet: "Qeveria me programet nga neni 7 i ketij ligji".

Pas paragrafit (11) shtohet paragraf i ri (12), si vijon:

"(12) Aktivitetet nga paragrafi (8) i ketij neni mund të financohen nga programet nga neni 7 i ketij ligji".

Neni 12

Neni 86 ndryshohet si vijon:

"(1) Grupi i masave për permiresimin e kualitetit të jetes në ambiente rurale jane masa të drejtuara në:

- vendosjen dhe zhvillimin e infrastruktures teknike dhe të telekomunikimit, infrastruktures komunale, infrastruktures së tregut dhe sociale në ambientet rurale,
- perteritjen dhe zhvillimin e fshatrave dhe
- ruajtjen dhe perparimin e kurioziteteve natyrore dhe kulturore dhe vlerave tradicionale në rajonet rurale.

(2) Llojin e masave nga paragrafi (1) i ketij neni, shfrytezuesit e masave, shumen e mjeteve sipas masave, lartesine e perkrahjes dhe menyren e zbatimit të tyre i percakton Qeveria me programet nga neni 7 i ketij ligji."

Neni 13

Në nenin 90 paragrafet (2) dhe (3) ndryshohen si vijojne:

"(2) Shpenzimet e pranueshme nga dispozitat e neneve 70, 71, 72, 73, 81, 86 dhe 87 të ketij ligji, perfshijne:

- blerje të kafsheve të gjalla dhe bimeve shumevjecare,
- ndertim ose permiresim të prones së patundshme,
- ndertim ose permiresim të infrastruktures (infrastruktures teknike dhe të telekomunikimit, infrastruktures komunale, të tregut dhe sociale),
- blerje ose lizing të mekanizimit dhe pajisjes, duke perfshire edhe softuer kompjuterik dhe
- investime tjera jomateriale dhe sherbime të lidhura me aktivitete paraprake, pergatitje dhe/ose realizim të investimit."

(3) Kushtet më të peraferta nga paragrafi (1) i ketij neni, shpenzimet e pranueshme nga paragrafi (2) i ketij neni, lartesine e vleres së shpenzimeve të pranueshme, si dhe lartesine e perkrahjes për shfrytezues për mase individuale i percakton ministri."

Neni 14

Neni 92 ndryshohet si vijon:

"(1) Masat për zhvillim rural zbatohen nepermjet ketyre mekanizmave të perkrahjes:

- perkrahje e pakthyeshme financiare për investime,
- ndihme financiare dhe
- pagesa direkte për zhvillim rural.

(2) Ndhime e pakthyeshme financiare për investime eshte perkrahja që ndahet në forme financimi ose kofinancimi të vleres së investimeve të ndermarra dhe të realizuara në pajtim me shpenzimet e pranueshme dhe në lartesi të perkrahjes për shfrytezues nga neni 90 i ketij ligji.

(3) Perkrahja e pakthyeshme financiare nga paragrafi (1) alineja 1 të ketij neni mund të ndahet edhe për investime jomateriale në pajtim me shpenzimet e pranueshme dhe në lartesi të perkrahjes për shfrytezues nga neni 90 i ketij ligji, e në pajtim me programet nga neni 7 të ketij ligji.

(4) Mjetet e lejuara dhe të paguara jane të pakthyeshme me ç'rast shfrytezuesi nuk guxon ta tjetersoje as ta prishe dedikimin e investimit në afat prej pese deri në shtate vjet nga dita e pranimit të pageses së fundit të perkrahjes nga paragrafi (2) dhe (3) të ketij neni.

(5) Pagesa direkte për zhvillim rural eshte pagese kompensuese për perkrahje të të ardhurave të realizuara nga veprimtaria bujqesore si kompensim i humbjeve që kane ndodhur nga mosshfrytezimi i potencialit prodhues për shkak të zbatimit të praktikave bujqesore prodhuese për mbrojtjen e ambientit jetesor ose për shkak të shpenzimeve të rritura për zbatimin e standardeve më të larta për mbrojtjen e ambientit jetesor.

(6) Ndhima financiare eshte perkrahje që ndahet për trajnim dhe informim të prodhuesve bujqesore, sherbime keshilledhenese për zhvillim të bujqesise, fillimin me veprimtari bujqesore, leshimin e kryerjes së veprimtarise bujqesore dhe për grupe të prodhuesve.

(7) Perkrahja e pakthyeshme financiare për investime dhe pagesat direkte për zhvillim rural zbatohet nepermjet marreveshjes në kohezgjatje prej pese deri në shtate vjet.

(8) Me perjashtim, pagesat direkte për zhvillim rural mund të ndahen edhe nepermjet deklarates së kerkuesit me të cilen obligohet t'i respektoje kushtet për pagesa direkte për zhvillim rural dhe e cila perterihet çdo vit për kohezgjatje të së drejtes së perkrahjes, kurse realizohen në pajtim me dispozitat nga neni 47 i ketij ligji.

(9) Ndhima financiare zbatohet nepermjet marreveshjes në kohezgjatje prej tre deri në pese vjet.

(10) Me perjashtim, ndihma financiare për trajnim dhe informim të prodhuesve bujqesore mund të zbatohet nepermjet marreveshjes në kohezgjatje prej një deri në tre vjet.

(11) Në pajtim me programet nga neni 7 i ketij ligji, perkrahja e pakthyeshme financiare dhe ndihma financiare mund të ndahet në forme të pageses avance në lartesi deri 40% nga vlera e shpenzimeve të pranueshme nga nenet 66, 67, 68, 69 dhe 90 të ketij ligji.

(12) Në pajtim me programet nga neni 7 i ketij ligji, perkrahja e pakthyeshme financiare mund të ndahet në dy keste ose në pajtim me fazat e realizimit të investimit."

Neni 15

Titulli i nenit 101 dhe neni 101 ndryshohen si vijojne:

"Perkrahja teknike në bujqesi dhe zhvillim rural

(1) Perkrahja teknike në bujqesi dhe zhvillim rural eshte e dedikuar për keto aktivitete:

- organizim dhe zbatim të programeve për trajnim të cilat nuk perkrahen nepermjet masave për zhvillim rural,

- organizim dhe zbatim të manifestimeve dhe panairove,

- pjesemarrje në manifestime të panairove dhe panaire të prodhuesve dhe perpunuesve bujqesore,

- ndihme për marketing të prodhimeve bujqesore dhe prodhimeve të perpunuara bujqesore,

- perpunim dhe publikim të materialeve edukative, shkencore, propaganduese dhe profesionale, publikimeve dhe revistave,

- zbatim i hulumtimeve, perpunim i analizave, propozim projekteve, studimeve dhe dokumenteve strategjike nga fusha e bujqesise dhe zhvillimit rural,

- investime për vendosjen e shembujve shkencore demonstrative,

- vendosje dhe zbatim i projekteve për inovacione nga sferat e percaktuara në paragrafin (3) të ketij neni dhe

- shpenzime dhe investime tjera për vendosjen dhe zbatimin e masave nga programet e nenit 7 të ketij ligji.

(2) Perkrahjen teknike nga paragrafi (1) i ketij neni e zbaton Ministria.

(3) Me perjashtim, perkrahjen teknike nga paragrafi (1) alineja 4 të ketij neni mund ta zbatoje Agjencia.

(4) Perkrahja teknike nga paragrafi (1) alinete 1, 2, 5, 6, 7 dhe 8 të ketij neni mund të ndahet varesisht nga:

- rezultatet reale dhe të zbatueshme me efekte të shpejta për realizimin e qellimeve të perkufizuara strategjike për zhvillim të bujqesise dhe zhvillim rural,

- ndikimi direkt dhe indirekt të numrit më të madh të subjekteve në fushen e bujqesise,

- bashkimi i shfrytezuesve të perkrahjes, partneriteti publik-privat, ose formave tjera të partneritetit me numer të madh shfrytezuesish,

- qendrueshmeria pas realizimit të perkrahjes,

- pervoja paraprake në realizimin e aktiviteteve me rendesi për tere grupin e shfrytëzuesve të fundit të përkrahjes dhe

- pjesëmarrja personale ose pjesëmarrja nga burime tjera të financimit.

(5) Përkrahja teknike nga paragrafi (1) alineja 9 të këtij ligji ndahet posaçërisht në këto fusha të inovacioneve:

- mekanizëm bujqësor dhe pajisje që do të mundësojë efikasitet dhe produktivitet më të madh,

- material të ri faror dhe për mbëltrim që do të mundësojnë krijimin e varieteteve të reja,

- trajtim agrokimik i tokës dhe kulturave bujqësore,

- transfer i teknologjive dhe zgjidhjeve inovative nga shtetet e huaja dhe përshtatja e tyre në Republikën e Maqedonisë dhe

- teknologji të reja në blegtori.

(6) Mjetet për zbatimin e aktiviteteve nga paragrafi (1) alineja 9 të këtij neni sigurohen në lartësi deri 1% nga buxheti i përgjithshëm për zbatimin e programit vjetor për zhvillim rural.

(7) Llojin e aktiviteteve për përkrahje teknike në bujqësi dhe zhvillim rural, shumën maksimale për aktivitete, shfrytëzuesit, subjektet që marrin pjesë në procedurë dhe kriteret më të përafërta nga paragrafi (4) i këtij neni dhe mënyrën për ndarje, i përcakton Qeveria me propozim të Ministrisë.

(8) Pagesën e mjeteve për përkrahje teknike nga paragrafi (1) i këtij neni e kryen Agjencia me kërkesë të Ministrisë ose me kërkesë së shfrytëzuesit."

Neni 16

Pas nenit 101 shtohet nen i ri 101-a si vijon:

"Këshilli për inovacione dhe teknologji të reja në fushën e bujqësisë

Neni 101-a

(1) Për zbatimin e ndihmës nga neni 101 paragrafi (1) alineja 9 të këtij ligji, ministri formon Këshill për inovacione dhe teknologji të reja në fushën e bujqësisë të cilin e përbëjnë përfaqësues posaçërisht nga këto institucione:

- një përfaqësues nga Kabineti i Kryetarit të Qeverisë,

- një përfaqësues nga Sekretariati i përgjithshëm i Qeverisë - Kabineti i Zëvendëskryetarit të Qeverisë i obliguar për çështje ekonomike dhe koordinimi me resorë ekonomik,

- nga një përfaqësues nga institucionet e larta arsimore dhe institucionet shkencore nga fusha e bujqësisë,

- një përfaqësues nga Ministria e Financave,

- tre përfaqësues nga Ministria,

- një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës,

- një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë,

- një përfaqësues nga Agjencia,

- një përfaqësues nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe

- një përfaqësues nga Agjencisë për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë.

(2) Këshilli për inovacione dhe teknologji të reja në fushën e bujqësisë si trup këshillëdhënës i ministrit formohet posaçërisht për realizimin e këtyre detyrave:

- jep propozime për përkufizimin e masave dhe kriterëve për përkrahje të inovacioneve dhe transferin e teknologjive dhe njohurive nga fushat e përcaktuara në nenin 101 paragrafi (5) të këtij ligji,

- përpunon analiza afatshkurta dhe afatgjata dhe e ndjek zbatimin e masave për përkrahje dhe inovacione dhe transfer të teknologjisë dhe njohurive nga fushat e përcaktuara nga fushat e përcaktuara në nenin 101 paragrafi (5) i këtij ligji.

- jep mendime në lidhje me rezultatet e arritura nga zbatimi i masave për përkrahjen e inovacione dhe transferin e teknologjive dhe njohurive nga sferat e përcaktuara në nenin 101 paragrafi (5) i këtij ligji,

- përgatit dhe propozon indikatorë për ndjekje, i ndjek analizat e gjendjeve dhe rekomandimet e institucioneve arsimore dhe shkencore në lidhje me inovacionet dhe transferet e teknologjive dhe njohurive nga sferat e përcaktuara me këtë ligj dhe jep drejtime dhe rekomandime për zbatimin e inovacioneve dhe transfereve të teknologjive dhe njohurive dhe përshtatjen e tyre në pajtim me gjendjet në Republikën e Maqedonisë dhe

- jep propozime gjatë planifikimit dhe zbatimit të qëllimeve për promovimin dhe zbatimin e inovacioneve dhe transfereve të teknologjive dhe njohurive nga sferat e përcaktuara në nenin 101 paragrafi (5) i këtij ligji.

(3) Këshilli për inovacione dhe teknologji të reja në sferën e bujqësisë do të takohet së paku dy herë në vit.

(4) Këshilli për inovacione dhe teknologji të reja në sferën e bujqësisë për realizimin e detyrave nga paragrafi (2) i këtij neni miraton rregullore për punë.

(5) Me Këshillin për inovacione dhe teknologji të reja në sferën e bujqësisë kryeson ministri.

(6) Ministria siguron përkrahje administrative, teknike dhe financiare për punën e Këshillit.“

Neni 17

Në nenin 102 paragrafi (1) alineja 2 fjalët “ose femër” shlyhen.

Pas paragrafit (2) shtohen tre paragrafë të rinj (3), (4) dhe (5) si vijojnë:

“(3) Ndhimja nga paragrafi (1) i këtij neni në mënyrë përmbledhëse nuk mund të tejkalojë 15% nga shuma e lejuar e pagesave të drejtpërdrejta në një vit kalendarik.

(4) Ndhimë plotësuese në lartësi prej minimum 20% mund t’u ndahet ekonomive bujqësore shfrytëzues të pagesave të drejtpërdrejta nga neni 47 i këtij ligji bartësi i së cilës është kryerës i regjistruar i veprimtarisë bujqësore në pajtim me Ligjin për kryerjen e veprimtarisë bujqësore ose është regjistruar si bujk individual në pajtim me Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor.

(5) Lartësinë e ndihmës plotësuese dhe shumat maksimale nga paragrafët (1) dhe (4) të këtij neni për shfrytëzues, i përcakton Qeveria me programet nga neni 7 i këtij ligji.”

Neni 18

Pas nenit 106 shtohet titulli i ri dhe neni i ri 106-a, si vijojnë:

"Ndhimja uzufuktuesve

Neni 106-a

(1) Ndhimja për kategori të veçanta të bartësve të ekonomisë bujqësore mund të ndahet në formë të ndihmës së njëfishtë për shfrytëzues të tokës bujqësore shtetërore uzufuktuesve në pajtim me Ligjin për tokë bujqësore edhe atë në lartësi jo më shumë se 120 000 denarë për shfrytëzues në vitin kur për herë të parë është marrë e drejta për shfrytëzimin e tokës bujqësore shtetërore në uzufukt.

(2) Lartësinë e ndihmës që ndahet për shfrytëzues varësisht nga kultura bujqësore për të cilën është ndarë toka bujqësore shtetërore në uzufukt si dhe shumën maksimale të ndihmës së njëfishtë, i përcakton Qeveria me Programin për ndarjen e tokës bujqësore në pronësi shtetërore në uzufukt kategorive të caktuara të personave të pasiguruar socialë në pajtim me Ligjin për tokë bujqësore.”

Neni 19

Në nenin 107 paragrafi (1) fjala “familjare” shlyhet.

Neni 20

Në nenin 108 fjalët: “dhe Agjencisë” shlyhen.

Neni 21

Rregullat më të afërta të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen në periudhë prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në ditën e hyrjes në fuqi të rregullave nga paragrafi (1) i këtij neni do të zbatohen rregullat ekzistuese.

Neni 22

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve nga programi vjetor për përkrahje financiare në bujqësi për vitin 2012 kanë edhe shfrytëzuesit të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk i kanë përmbushur të gjitha detyrimet financiare ndaj Ministrisë dhe do të pajtohen që detyrimet e papaguara nga neni 14 paragrafi (2) i këtij ligji t'i përmbushin me përkrahjen e miratuar financiare në bazë të programit vjetor për përkrahje financiare në bujqësi për vitin 2012.

Mënyrën e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton Qeveria me rregullën nga neni 47 paragrafi 6 të këtij ligji.

Neni 23

Femrat bartëse të ekonomisë bujqësore familjare të cilat deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji e kanë marrë të drejtën e shfrytëzimit të ndihmës për kategori të veçanta të bartësve të ekonomisë bujqësore si ndihmë plotësuese që u ndahet ekonomive bujqësore shfrytëzuese të pagesave të drejtpërdrejta nga neni 47 i këtij ligji, kanë të drejtë shfrytëzimi të ndihmës deri në skadimin e periudhës nga neni 102 paragrafi (2) të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 49/10 dhe 53/11).

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.